



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KRYETARI**

Nr 6600 Prot.

Vau Dejës me 21 . 11 . 2022

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

Z. Mark Bisha
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar z. Kryetar

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt Vendimin.

“Për miratimin në parim të dhënies me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 0.483 Ha, të pasurisë nr 76, Zk nr 2708, e llojit “Pemë”, ndodhur në fshatin Mnelë e vogël, Nj. Adm Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë:

1. Projekt vendimin
2. Relacionin
3. Kopje e Kartelës së pasurisë nr 76, Zk 2708, lëshuar nga ASHK, DV Shkoder..
4. Kopje e fletës së inventarit dhe VKM-së përkatëse.
5. Plan rilevimin e pasurisë.

Me respekt,

KRYETARI
Mark BABANI



Konceptoi: Ndoc Baqli

Datë: _____

Nr faqeve A4 të projekt-propozimit _____

Nr faqeve A4 të dokumenteve që shoqërojnë projekt-vendimin _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

PROJEKT VENDIM
Nr 10. Datë 21.11.2022

Për miratimin në parim të dhënies me qira të sipërfaqes prej 0,483 Ha, pasuria nr 76, Zk nr 2708, e llojit “Pemë”, Njesia Administrative Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 10, datë, 07.01.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, në Komunën Vig Mnelë të Qarkut të Shkodrës”, ligji nr 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ligji nr 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, Udhëzimi nr 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak Vau Dejës të:

VENDOSI :

1. Dhënie pëlqimi në parim për dhënien me qira të sipërfaqes prej 0.483 Ha, të pasurisë nr 76, Zk nr 2798, e llojit “Pemë”, në fshatin Mnelë e vogël, Nj.Ad Vig Mnelë, Bashkia Vau Dejës, e cila mund të përdoret për veprimtari bujqësore, sipas kërkesave të subjekteve të interesuar.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Tarifa e qirasë vjetore dhe afati i dhënies me qira të jetë në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

KRYETARI
Mark BABANI



Konceptoi: Ndoc Baqli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE

RELACION

DHËNIE NË PËRDORIM TË PASURISË SHTETËRORE E LLOJIT “PEMË” ME
SIPËRFAQE PREJ 0,483 HA, NË FSHATIN MNELEË.

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të tjera ka edhe administrimin dhe shfrytëzimin e resurseve të saj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posaçërisht të kaluara në pronësi të saj, me qëllim dhënien në përdorim të tretëve, me objektiv për të siguruar të ardhura për bashkinë, që më pas kthehen në investime publike, si dhe duke hapur vende të reja pune me impakt zbutjen e varfërisë dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së jetës në komunitet.

Mirëadministrimi i Aseteve publike, është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mire.

Me transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore në administrimin vendor menaxhimi i asetëve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë.

Bazuar në ligjin nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr 8744 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit, në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar, Bashkia jep në përdorim subjekteve të interesuar, pasuritë e paluajtshme në pronësi të saj, me kontratë qiraje, sipas procedurave përkatëse. Bazuar në Udhëzimin nr 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, objekt i këtij udhëzimi janë tokat e regjistruara si të tilla në regjistrat kadastralë dhe që kanë qenë në përbërje të ish kooperativave bujqësore, por që kanë mbetur pa u ndarë sipas ligjit nr 7501, datë 19.07.1991, “Për token”. Këto pasuri jepen me qira sipas udhëzimit të mësipërm, me afate kohore sipas planit të biznesit dhe llojit të veprimtarisë bujqësore që do të ushtrohet nga ana e subjektive të interesuar.

Objekt i qiradhënies së tokës bujqësore është pasuria nr 76, Zk nr 2708, në fshatin Mnelë e vogël, me sip 0.483 Ha, e llojit “Pemë”. Me shkresën nr 348 prot, datë 26.01.2022, (bashkëlidhur) kemi bërë kërkesë për regjistrim të kësaj pasurie, por meqenëse akoma nuk është kryer çertifikimi, kemi nxjerrë Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme dhe Fragment të hartës Kadastrale, në ASHK. Nga gjendja reale e parcelës në terren, rezulton se kjo parcele është e lirë dhe , e gatshme për zhvillim aktiviteti bujqësor.

Pas miratimit në Këshillin Bashkiak, dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut, vazhdon procedura e konkurimit me të gjithë elementet e saj përbërës deri në shpalljen e fituesit.

Për sa më sipër, ju ftojme për të miratuar këtë Projekt Vendim.

KRYETARI
Mark BABANI



Hartuesit e relacionit: Ndoc Baqli

Ilda Prendi

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 1 Fq. 76

SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

--> Vijon nga: Vol. _____ Fq. _____

Zona Kadastrale: 2708 NR. i PASURISE: 76 Vijon në: Vol. _____ Fq. _____ deri në: Vol. _____ Fq. _____ -->

Indeksi i Hartës: K-34-76-(24-A)

PERFUNDIMTARE (data): 17/04/2001

Adresa e pasurisë: Rrethi SHKODER Q/IF MHELE E VOGEL
 Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

Përshkrim i Veçantë

SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Loji i Pasurisë: PEME Brenda V.K.N.: Jo --> Po, Ref: _____

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
_____ m ²	1. _____ m ²	1. _____ m ²
Ref _____	Ref _____	Ref _____
<u>4830</u> m ²	2. _____ m ²	2. _____ m ²
Ref <u>LN 64SHT 2000</u>	Ref <u>LN 64SHT 2000</u>	Ref <u>LN 64SHT 2000</u>
_____ m ²	3. _____ m ²	3. _____ m ²
Ref _____	Ref _____	Ref _____
_____ m ²	4. _____ m ²	4. _____ m ²
Ref _____	Ref _____	Ref _____

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT

Kuota e Pjesëmarrjes:

_____ %

Nr. i Pasurisë (Pallat):

Vol. _____ Fq. _____

SEKSIONI I PRONESISE

Dok	Data Regjistrim	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
	<u>1.09.2000</u>	<u>SHTETI</u>			<u>SHKODER</u> <u>MHELE E VOGEL</u>				

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARRJEVE TË UJJEVE KUFIZUESE,
SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TË TJERA

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shën.

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok.	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shën.

HARTE TREGUESE E RREGJISTRIMIT

(Fragment)

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZYRA E RREGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
SHKODER

ZONA KADASTRALE : 2708
NUMRI I PASURISE 76 VOL. FAQE
INDEKSI I HARTES : K-34-76-(24-A) SHKALLA : 1: 2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi: SHKODER Q/F: MNELE E VOGEL


B.KUFIZIMET

PRONARI

V. _____
L. _____
J. _____
P. _____

Ing . E. RamaJ *[Signature]*

Dt. 22.11.2021



COMPTON PER INVOKUJIZIMIN E PROMAVE TE TALLUATSIONE SHITERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
132	40-A	424	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	1544		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	
133	40-A	425	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	2123		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	
134	40-A	426	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	15700		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	
135	40-A	464 *	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	25309		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	
136	23-B 24-A	73	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	9350		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	
137	23-B 24-A	74	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	3941		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	
138	24-A	76	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	4830		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	
139	24-A	77	Shesh	Shesh Mnele e Vogel	8105		Infrastruktura	Komuna Vig Mnele	Komuna Vig Mnele	

PLAN RILEVIMI

PERGATITI

HAMID ÇULIQ

Liçensa T. 0675/2 Dt: 10.04.2018

Data e përgatitjes: 20.11.2022

- SIPERFAQE

$S_{IP}=4830 \text{ m}^2$

NG TOPOGRAFI
HAMID ÇULIQ
Vllaz/Firma
NR. LIÇENSA 0675/2

A.IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2708

NR.PASURISE 76 VOL _____ FQ _____

SHKALLA 1 : 2500

INDEKSI I HARTES K-34-76-(24-A)

ADRESA E PASURISE : Rrethi SHKODER

FSHATI : MNELE E VOGEL

QIRAMARRES : NDUE GJERGJ LALA

